VENDIM
Nr.78, datë 23.10.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "MALIDO ENERGJI" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa "a", 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe neneve 13 dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Malido Energji" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Mosplotësimin e lejes për pikën e lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, pika "a"), pasi aplikuesi është në proces negocimi me OSSH sh.a dhe DPR-në për t'u lidhur në rrjetin 20 kV në N/st, i cili furnizon me energji elektrike tunelin e Kalimashit.

Për gjithë sa më sipër cituar:

VENDOSI:

1. Miratimin e licencimit të shoqërisë "Malido Energji" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Klos".
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta